

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË KONTIGJENCËS

PËR FLUKSET E PËRZIERA MIGRATORE, PËR VITET 2026-2028”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektakti është miratimi i Planit Kombëtar të Kontigjencës për flukset e përziera migratore, për vitet 2026-2028.

Në një periudhë ku fenomenet e migracionit po marrin përmasa gjithnjë e më të mëdha dhe ndikojnë në dimensionet sociale, ekonomike, politike dhe kulturore të shumë shteteve, Shqipëria si një shtet i Ballkanit Perëndimor nuk është përjashtuar nga këto zhvillime.

Migracioni ka qenë dhe mbetet një ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e vendit, si për nga drejtimi i flukseve migratore, ashtu edhe për pasojat që ato lënë pas. Në këtë kuadër, zhvillimi dhe implementimi i një plani kombëtar të kontigjencës për flukset e përziera migratore është një nevojë urgjente për të përballuar sfidat që dalin nga ky fenomen.

Plani kombëtar i kontigjencës për flukset e përziera migratore është një instrument strategjik që ka për qëllim të sigurojë menaxhimin e duhur të migracionit dhe azilit. Ky plan ndihmon në identifikimin e pasojave të mundshme të flukseve të migracionit dhe në përgatitjen për to, duke ofruar gjithashtu masa që mund të merren për të adresuar sfidat dhe mundësitë që lidhen me migracionin.

Në kuadrin e politikës kombëtare të migracionit dhe asaj rajonale, ky plan ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Ai jo vetëm që kontribon në përballimin e flukseve të migracionit, por gjithashtu është në përputhje me angazhimet e Shqipërisë ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve ligjore që rregullojnë migracionin, duke përfshirë Paktin Global për Migracionin të Kombeve të Bashkuara, Planin Global për Refugjatët, si dhe angazhimet që Shqipëria ka ndaj Bashkimit Evropian.

Qëllimi kryesor i hartimit të një Plani të Kontigjencës është forcimi i kapaciteteve shtetërore për të menaxhuar në mënyrë efektive dhe të organizuar sfidat që vijnë nga lëvizjet masive të popullsisë, nëpërmjet një qasje të unifikuar ndërinstitucionale, me vëmendje të shtuar tek mbrojtja e të drejtave të njeriut, ndihma humanitare, kontrolli kufitar dhe ruajtja e rendit publik, si dhe siguria e shëndetit publik.

Plani parashikon se institucionet përgjegjëse të përfshira, kanë detyrimin të hartojnë dhe zbatojnë planet e tyre sektoriale të veprimit, në përputhje me këtë Plan Kontigjence dhe me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile.

Ky plan është një mjet i rëndësishëm për të siguruar që Shqipëria të jetë e përgatitur për të përballuar çdo situatë emergjente që mund të dalë si pasojë e lëvizjeve të paplanifikuara të imigracionit. Si një shtet që ndodhet në një rajon të brishtë, me një histori të gjatë migracioni dhe si një destinacion për imigrantët që kalojnë përmes territorit shqiptar në drejtim të vendeve të tjera të BE-së, Shqipëria ka nevojë për një sistem të menaxhimit të migracionit dhe azilit që është i shpejtë, efikas dhe i koordinuar.

Projektakti ka për qëllim të krijojë një kuadër të unifikuar dhe të qëndrueshëm për trajtimin e flukseve të përziera migratore, duke u bazuar në parimet e menaxhimit të integruar të migracionit, i cili është i orientuar nga nevojat humane dhe synon gjithashtu përfitime afatgjata për shtetin dhe shoqërinë shqiptare.

Synimi është përgatitja e të gjitha institucioneve dhe strukturave qendrore dhe vendore për përballimin dhe menaxhimin me sukses të krizës së flukseve të përziera migratore, që parashikohet të vijnë në rritje, në kufijtë dhe territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shqipëria, si shtet kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duhet të tregojë angazhimin e saj të fortë për të përmbushur kërkesat dhe standardet evropiane për menaxhimin e migracionit, duke përfshirë gjithashtu bashkëpunimin e ngushtë me shtetet fqinje dhe me institucionet ndërkombëtare. Specifikisht, Plani i parashikuar synon të garantojë respektimin e të drejtave të njeriut të migrantëve dhe azilkërkuesve në Shqipëri, përmes përmirësimit të kapaciteteve për identifikimin, përpunimin dhe dhënien e shërbimeve për migrantët dhe azilkërkuesit në shkallë të gjerë. Kjo synohet të arrihet duke krijuar një mjedis ku migrantët të ndjehen të sigurtë.

Projektakti ka për qëllim të parashikojë përmbushjen e kërkesave të migrantëve për zhvendosje, evakuim, komunikim, strehim në situatë emergjente, ndihmë ushqimore, kujdes shëndetësor dhe mbështetje psikosociale.

Duke pasur parasysh, se kjo është një çështje rajonale dhe globale, qeveria do të marrë të gjitha masat për të punuar në partneritet të ngushtë me vendet fqinje, vendet e mundshme të destinacionit dhe aty ku është e mundur edhe me vendet e origjinës, si edhe me organizatat ndërkombëtare në përputhje me mandatet specifike dhe fushat e ekspertizës. Bashkëpunimi do të realizohet përmes koordinimit të përmirësuar dhe shkëmbimit të informacionit, përfshi edhe dhënien rregullisht, të informacionit të përditësuar, mbi arritjet dhe të dhënat për rastet e zbuluara, si dhe për hapat e mëtejshëm.

Plani kombëtar i kontigjencës për flukset e përziera migratore vjen si një instrument tërësor që ndihmon në menaxhimin efikas të migracionit. Hartimi i tij është një hap i rëndësishëm për të siguruar që Shqipëria të jetë e përgatitur dhe të përmbushë kërkesat e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ministria e Punëve të Brendshme është angazhuar në përgatitjen e këtij projektakti, në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka në kompetencë, si organ përgjegjës për hartimin dhe zhvillimin e politikave kombëtare për menaxhimin e

migracionit dhe azilit, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Ky projektakt nuk është parashikuar në programin analitik të Këshillit të Ministrave për vitin 2025.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektakti është hartuar në përgjigje të situatës emergjente migratore në rajon e cila ka prekur edhe vendin tonë. Flukset migratore drejt Bashkimit Evropian (BE) janë të lidhura ngushtësisht me pasigurinë në vendet e origjinës dhe të tranzitit, si Afganistan, Pakistan, Iran, Siri, Liban dhe Gaza. Këto rajone vazhdojnë të jenë burim lëvizjesh migratore. Flukset migratore në Mesdheun Lindor janë rritur gjatë vitit 2024, veçanërisht në drejtim të Greqisë përmes Turqisë dhe Libisë. Migrantët që arrijnë në këtë rajon shpesh kalojnë përmes Ballkanit Perëndimor, me dy rrugë kryesore migrimi: rruga qendrore përmes Serbisë dhe rruga përmes Shqipërisë.

Këto rrugë mbeten aktive dhe krijojnë flukse migratorie të mëdha drejt veriut. Sipas statistikave, kalimet e paligjshme të kufirit në vitin 2023 ishin 178,000, ndërsa në vitin 2024 ranë në 63,600. Sirianët, Afganët, Marokenët dhe Pakistanezët janë kombësitë kryesore që kalojnë nga Turqia, ndërkohë që një numër gjithnjë e më i madh i grave dhe fëmijëve të pashoqëruar kërkojnë mbrojtje, duke nënvizuar nevojën për një përgjigje më të ndjeshme ndaj këtij grupi vulnerabel.

Një problem tjetër është përdorimi i vizave (shengen kryesisht) nga shtetas që përpiqen të kalojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e Bashkimit Evropian. Aktivitetet e kontrabandimit të migrantëve, përfshirë përdorimin e armëve dhe dhunën, vazhdojnë të jenë shqetësim për sigurinë, veçanërisht në zonat kufitare. Në Shqipëri, flukset migratore janë përqendruar kryesisht në kufirin jugor me Greqinë, dhe kalimet shpesh drejtohen në kufirin me Malin e Zi dhe Kosovën për të hyrë në territorin e BE-së.

Kufiri me Greqinë ka qenë gjithmonë zona me më shumë aktivitet migrator, duke përbërë mbi 84% të ndalimeve në vitin 2022. Edhe në vitin 2024, ky kufi mbetet i rëndësishëm për menaxhimin e flukseve migratore, megjithëse numri i ndalimeve

është ulur ndjeshëm. Kufiri me Malin e Zi dhe Kosovën ka pësuar një rënie graduale, por ende mbetet një zonë strategjike për kalimin e migrantëve drejt BE-së. Megjithatë, kufiri detar kërkon monitorim të vazhdueshëm për shkak të rritjes së përkohshme të aktiviteteve migratore.

Në përgjithësi, Shqipëria vazhdon të jetë një aktor kyç në menaxhimin rajonal të migracionit, duke u përballur me sfida të mëdha, që kërkojnë marrjen e masave për përmirësimin e kapaciteteve kombëtare për të menaxhuar flukset migratore dhe për të garantuar sigurinë dhe rendin publik.

Lidhja e projektaktit me Politikat Kombëtare, Rajonale dhe Evropiane të Migracionit dhe Azilit

Politika kombëtare e migracionit e Shqipërisë ka si qëllim menaxhimin e flukseve të migracionit dhe garantimin e të drejtave të migrantëve. Në këtë kuadër, plani i kontigjencës është një mjet i rëndësishëm për t'i dhënë prioritet qëndrueshmërisë sociale dhe ekonomike, duke u mundësuar individëve dhe grupeve migratore që të integrohen në shoqërinë shqiptare, por gjithashtu duke ofruar një kuadër të sigurt për ata që mund të jenë të detyruar të migrojnë për shkak të situatave emergjente.

Një komponent kyç i politikës kombëtare të migracionit është bashkëpunimi me shtetet fqinje dhe me partnerët ndërkombëtarë, duke përfshirë Bashkimin Evropian dhe organizatat ndërkombëtare si IOM dhe UNHCR. Ky bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar është i domosdoshëm për të trajtuar migracionin në mënyrë të qëndrueshme dhe për të siguruar një menaxhim të efektshëm të flukseve migratore që mund të krijohen nga kriza të ndryshme politike, ekonomike ose natyrore.

Detyrimi për hartimin e Planit të Kontigjencës buron nga parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM) 2024-2030 dhe Planit të saj të Veprimit 2024-2026, ku kërkohet hartimi dhe miratimi i Planit të Kontigjencës.

Gjithashtu, hartimi i këtij plani vjen edhe si detyrim i zbatimit të Planit të Veprimit të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe rekomandimeve të Progres Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për kapitullin 24, si dhe në mbështetje të Paktit të Migracionit dhe Azilit (Pakti i Komisionit Evropian, 2020, miratuar në maj 2024). Ky pakt përfshin një mekanizëm të ri solidariteti dhe bashkëpunimi ndërmjet

shteteve anëtare për të menaxhuar flukset e migrantëve dhe refugjatëve dhe për të siguruar një përgjigje të shpejtë ndaj krizave të migracionit.

Projektakti vjen edhe në përmbushje të Udhërrëfyesit të Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Evropiane për Azilin (EUAA) dhe Shqipërisë (Tetor 2024 – Shtator 2027). Ai garanton bashkëpunimin ndërinstitutional ku të gjitha palët duhet të zbatojnë një plan veprimi të përcaktuar për të siguruar që Planit të jetë gjithëpërfshirës, i zbatueshëm dhe në përputhje me standardet e BE-së.

Përputhja me Paktin Global për Refugjatët

Projektakti mbështet objektivat e Paktit Global për Refugjatët, duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e refugjatëve, me fokus në sigurinë dhe dinjitetin e tyre, si dhe duke i kushtuar rëndësi nevojës për të garantuar akses në strehim, kujdes shëndetësor dhe arsim për të gjithë ata individë që janë të detyruar të largohen nga vendet e tyre të origjinës për shkak të krizave të ndryshme.

Përputhja me Paktin Global për Migracionin

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i hartimit të Planit të Kontigjencës për Migracionin është përputhja e tij me angazhimet ndërkombëtare që Shqipëria ka marrë mbi vete. Pakti Global për Migracionin, i miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 2018, është një instrument i rëndësishëm që promovon një menaxhim të qëndrueshëm dhe të sigurt të migracionit. Ky pakt synon të ndihmojë shtetet të përballen me sfidat që sjell migracioni, duke siguruar që flukset migratore të menaxhohen në mënyrë humane dhe të organizuar.

Përputhja e Planit të Kontigjencës me Paktin Global për Migracionin është thelbësore për Shqipërinë për të treguar përkushtimin e saj për të respektuar standardet ndërkombëtare dhe për të siguruar që politikat e saj të migracionit të jenë në përputhje me parimet dhe objektivat e këtij pakti.

Ky pakt thekson rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut për migrantët dhe ndihmën për ata që janë të detyruar të migrojnë për shkak të situatave të vështira, duke përfshirë sigurinë dhe integritetin e tyre në shoqëri. Implementimi i këtij plani do të kontribuonte gjithashtu në realizimin e angazhimeve të Shqipërisë ndaj

Bashkimit Evropian, duke garantuar që politikat e migracionit të jenë në përputhje me ato të BE-së dhe të përmirësojnë mundësitë e integritit të Shqipërisë në BE.

Elementët kryesorë që rregullon projektakti

Projektakti është i domosdoshëm, duke patur parasysh se kapacitetet pritëse të Shqipërisë mbeten të kufizuara dhe konsistojnë në një qendër kombëtare pritjeje për azilkërkuesit, një qendër të mbyllur për migrantët në Tiranë/Karreç dhe katër qendra të përkohshme pritjeje.

Kapacitetet pritëse të Shqipërisë për menaxhimin e flukseve migratore janë të përqendruara kryesisht në disa zona të caktuara, duke krijuar një mbulim jo të balancuar në nivel territorial. Struktura më e madhe është Qendra e Pritjes për Azilin në Tiranë, e cila ofron akomodim për deri në 250 persona që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. E rinovuar në vitin 2022 sipas standardeve ndërkombëtare, kjo qendër bashkëpunon ngushtësisht me organizata si UNHCR për mbështetje dhe ri-integrim. Përveç kësaj, ekzistojnë qendra të tjera regjistrimi dhe akomodimi të përkohshëm, si ato në Gërhot, Kakavijë dhe Kapshticë, të cilat ofrojnë akomodim për 10 orë dhe luajnë një rol të rëndësishëm në menaxhimin fillestar të migracionit.

Për fëmijët e huaj të pashoqëruar, deri në vitin 2026 do të ngritet një qendër e re pritëse që do të ofrojë shërbime psiko-sociale dhe mjekësore. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet në partneritet me IOM dhe UNHCR. Ndërkohë, Karreçi është e vetmja qendër e mbyllur për migrantët e parregullt, me kapacitet 100 shtretër për mbajtjen e përkohshme deri në përfundimin e procedurave të identifikimit ose dëbimit.

Plani i parashikuar për ngritjen e kapaciteteve pritëse emergjente për menaxhimin e flukseve migratore mbështetet mbi një shpërndarje të balancuar të qendrave në qarqet Korçë, Gjirokastër dhe Vlorë. Këto qendra synojnë të shfrytëzojnë infrastrukturën ekzistuese publike, hapësirat e braktisura apo truallin e lirë, duke garantuar reagim të shpejtë dhe funksional në rast të flukseve të papritura migratore.

Në qarkun e Korçës parashikohet ngritja e disa strukturave të akomodimit emergjent. Në Bashkinë Korçë është identifikuar fshati Floq në Njësinë Administrative Mollaj, në ambientet e ish-TAP. Në Bashkinë Pogradec, krijohen mundësi për ngritjen e

qendrave me kapacitet të konsiderueshëm. Në Bashkinë Devoll, hapësirat e qytetit Bilisht dhe të fshatit Bitinckë ofrojnë gjithsej mbi 11.500 m², duke e bërë këtë bashki një nyje të rëndësishme pritjeje. Bashkia Kolonjë ofron gjithashtu hapësira strategjike.

Në Bashkinë Maliq parashikohet shfrytëzimi i ish-depove të Rezervave Shtetërore në Lozhan, ndërsa në Bashkinë Pustec janë evidentuar tre hapësira: Njësia Zaroshkë, fusha sportive e Pustecit dhe fusha sportive e Goricës së Vogël. Në total, qarku Korçë përfshin të paktën 10 pika akomodimi emergjent.

Në qarkun e Gjirokastrës, fokusi është vendosur mbi rikonfigurimin e strukturave ekzistuese, kryesisht ish-Rezervat Shtetërore, të cilat kanë treguar funksionalitet gjatë krizës së vitit 1999. Në Bashkinë Memaliaj, pranë Stadiumit “Karafil Çaushi” është parashikuar vendosja e strukturave të përkohshme, ndërsa në Bashkinë Përmet janë evidentuar spitali i qytetit dhe konviktet, që mund të akomodojnë deri në 102 shtretër. Në këtë qark parashikohen të paktën tre pika të rëndësishme pritjeje, të cilat mund të shtohen në varësi të vlerësimeve të infrastrukturës.

Në qarkun e Vlorës është parashikuar një shpërndarje më e gjerë e kapaciteteve. Në Bashkinë Vlorë janë identifikuar disa hapësira kryesore: konviktet e “Qytezës së Studentit” dhe të Shkollës Industriale, si dhe objekte që mund të përshtaten për akomodim si Pallati i Sportit “Flamurtari”, Shkolla e Marinës dhe zyrat e Njesisë Administrative Novoselë. Secila prej këtyre hapësirave ka kapacitet deri në 300 persona, duke e kthyer qytetin e Vlorës në një qendër kryesore pritjeje. Në Bashkinë Selenicë, fshati Peshkopi ofron një terren me kapacitet deri në 250 persona. Në Bashkinë Delvinë është identifikuar stadiumi i qytetit. Në Himarë janë parashikuar stadiumi dhe ambientet e shkollave publike, ndërkohë që vijon procesi i vlerësimit për hapësira të tjera. Në Bashkinë Konispol, tre shkolla dhe Qendra Komunitare në Mursi ofrojnë një kapacitet total prej rreth 410 personash.

Në përmbledhje, plani parashikon ngritjen e mbi 20 qendrave/ambienteve pritëse në tre qarqe strategjike. Këto hapësira janë të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë pikat kufitare dhe zonat e ndjeshme ndaj flukseve migratore, duke ofruar fleksibilitet dhe gatishmëri për akomodimin e menjëhershëm të migrantëve në kushte emergjente. Ky rrjet qendrash synon të sigurojë një menaxhim të koordinuar,

duke minimizuar presionin mbi zonat urbane dhe duke shfrytëzuar maksimalisht infrastrukturën ekzistuese.

Projektakti synon gjithashtu forcimin e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për përpunimin e kërkesave të azilit, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke siguruar që çdo migrant të ketë mundësinë të shprehet dhe të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe me dinjitet.

Plani është hartuar mbi bazën e metodologjive të planifikimit të emergjencave të Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) dhe Agjencisë Evropiane për Rojën Kufitare dhe Bregdetare (FRONTEX), me qëllim krijimin e mekanizmave të përshtatshme për menaxhuar në mënyrë efektive flukset e përziera migratore, sipas standardeve të vendosura nga Bashkimi Evropian.

Plani i propozuar unifikon dy modelet e FRONTEX dhe EUAA të planit të kontigjencës, veçanërisht me qëllim integrimin e duhur në Plan të të gjithë elementëve të nevojshëm për menaxhimin kufitar dhe trajtimin e azilkërkuesve sipas standarteve të BE-së.

Plani i kontigjencës ka një qendër të qartë kordinuese dhe është i bazuar në katër skenarë të mirëpërcaktuar në përputhje me analizën e riskut në një kontekst ndërkombëtar, rajonal dhe kombëtar, përfshirë parashikimet për ndryshimet e trendeve migratore, të cilat ishin disa nga mangësitë e planit të mëparshëm të Shqipërisë.

Projektakti fokusohet në menaxhimin efikas të kufijve, duke përforcuar kapacitetet operative dhe koordinimin mes institucioneve të përfshira. Ky objektivi është thelbësor për të siguruar kontroll të sigurt dhe ligjor të kufijve, duke mbrojtur si sigurinë kombëtare ashtu edhe të drejtat e njeriut.

Nëpërmjet këtij plani, projektakti synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me aktorët ndërkombëtarë, për të menaxhuar krizën migratore në mënyrë gjithëpërfshirëse. Ky objektivi përfshin krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm koordinimi mes autoriteteve shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve përkatëse, si dhe promovimin e partneriteteve të forta që mund të sigurojnë mbështetje teknike dhe operacionale në kohë krize.

Plani parashikon zhvillimin e një strategjie të integruar të komunikimit publik gjatë krizave migratore. Kjo është e rëndësishme për të parandaluar keqinformimin dhe përhapjen e panikut. Ngritja e një platforme të centralizuar të komunikimit dhe trajnimi i zëdhënësve institucional është një hap tjetër i rëndësishëm për të garantuar transparencën dhe besimin e publikut në menaxhimin e krizës.

Gjithashtu, parashikohet edhe procesi i rishikimit të planit në 4-mujorin e fundit të vitit 2028.

Projektakti fokusohet në garantimin e rendit publik dhe sigurisë kombëtare në përputhje me të drejtat e njeriut, gjatë periudhave të krizave migratore, duke përdorur strategji të menaxhimit të situatave emergjente dhe duke zbatuar masa parandaluese. Të gjitha këto objektiva janë të domosdoshëm për të përballuar sfidat e migracionit në një mënyrë që respekton të drejtat e njeriut dhe siguron stabilitetin e vendit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti i propozuar është në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe është hartuar në përmbushje të parashikimeve të:

- Urdhrit të Kryeministrit nr.95 datë 12.6.2024 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Planit të Kontigjencës për Flukset e Përziera Migratore”;
- Vendimit nr. 271, datë 2.5.2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe të Planit të saj të Veprimit 2024–2026”;
- Vendimit nr. 736, datë 13.12.2023 “Për miratimin e udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës”.

Ky projektakt është në përputhje të plotë me:

- Ligjin Nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”;
- Ligjin Nr. 39/2025 “Për Kontrollin e Kufirit Shtetëror”;
- Ligjin Nr. 79/2021 “Për të huajt”, të ndryshuar ;

- Ligjin Nr. 22/2020 “Për disa shtesa në ligjin nr.71/2016 “Për kontrollin kufitar””;
- Ligjin Nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligjin Nr. 157/2013, “Për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr.10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 10383, datë 24.2.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 10138, datë 11.05.2009 "Për shëndetin publik", të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 147/2014 “Për Shërbimet e Urgjencës Mjekësore”;
- Ligjin Nr. 84/2024 “Për miratimin e planit afatgjatë të zhvillimit të forcave të Armatosura 2024–2033”;
- Ligjin Nr. 7978, datë 26.7.1995 “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;
- Ligjin Nr. 18/ 2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
- Ligjin Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH”;
- Ligji Nr. 51, datë 03.07.2025 “Për rezervat materiale të shtetit”;
- Ligji Nr. 147/2014 “Për shërbimin kombëtar të urgjencës mjekësore”;
- VKM Nr. 807, datë 28.12.2023, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile”;
- VKM Nr. 923, datë 25.11.2020 “Për Funksonimin e Organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Bashkëpunimin Ndërinstitucional i Institucioneve dhe të Strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile” ;
- VKM Nr. 241, datë 27.3.2013 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektakt nuk synon përafrimin me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përbëhet nga 12 seksione dhe nga 5 Aneksë, si më poshtë:

- Seksioni 1. Hyrja e planit
- Seksioni 2. Janë shkurtimet
- Seksioni 3. Terminologjia e përdorur
- Seksioni 4. Përcakton qëllimin e planit
- Seksioni 5. Përshkruan objektivat
- Seksioni 6. Përmban parimet themelore
- Seksioni 7. Përshkruan planifikimin dhe përgatitjen
 - Pika 7.1. Përcaktohet kuadri ligjor
 - Pika 7.2. Përmban një analizë të situatës në Bashkimin Evropian dhe rajon
 - Pika 7.3. Përmban analizë të situatës në Shqipëri, menaxhimi i kufirit
 - Pika 7.3.1. Paraqet situatën lidhur me të huajt e parregullt të ndaluar
 - Pika 7.3.2. Zonat kryesore të presionit migrator
 - Pika 7.3.3. Profilizimi i migrantëve të ndaluar sipas shtetësisë
 - Pika 7.3.4. Jep informacion lidhur me refuzimet në hyrje
 - Pika 7.4. Është lidhur me Mbrojtjen Ndërkombëtare, Azilin
 - Pika 7.4.1. Analizë lidhur me llojin e mbrojtjes 2022-2024
 - Pika 7.4.2. Sistemi i pritjes
 - Pika 7.4.3. Përshkruan kapacitetet shqiptare
 - Pika 7.5. Treguesit paralajmërues të hershëm dhe pragjet përkatëse
- Seksioni 8. Qeverisja – reagimi, koordinimi dhe menaxhimi i emergjencave në flukse të papritura migratore
 - Pika 8.1. Kuadri Institucional dhe funksionet kryesore
 - Pika 8.2. Mekanizmi i koordinimit dhe komunikimit
 - Pika 8.3. Mekanizmi i koordinimit dhe komunikimit në skenarin portokalli dhe të kuq
 - Pika 8.4. Monitorimi i treguesve të hershëm, pragjet dhe aktivizimi i skenarëve
- Seksioni 9. Përshkruhet plani i përgjigjes
- Seksioni 10. Plani operacional
- Seksioni 11. Reagimi ndërinstytucional dhe masat e menaxhimit për flukset migratore
- Seksioni 12. Buxheti

Aneksi I. Lista e kontakteve

Aneksi II. Pikat e hyrjes dhe daljes në kufijtë e Republikës së Shqipërisë

Aneksi III. Plani për krijimin e qendrave të akomodimit emergjent në Korçë, Vlorë, Gjirokastrë

Aneksi IV. Plani veprimit

Aneksi V. Kostimi

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera për të cilat në plan janë përcaktuar detyra të veçanta për zbatimin e këtij projektakti.

Plani është zhvilluar mbi parimet e ndarjes së qartë të përgjegjësisë, udhëheqjes së qëndrueshme qendrore dhe bashkëpunimit të ngushtë vendor dhe ndërkombëtar.

Në kuadër të Planit të Kontigjencës për Menaxhimin e Flukseve Migratore, për të garantuar një përgjigje të koordinuar dhe të përshkallëzuar në rast se treguesit tejkalojnë skenarin e verdhë dhe aktivizojnë skenarin portokalli, parashikohet aktivizimi i Task-Forcës Ndërinstitucionale për Menaxhimin e Flukseve Migratore, Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore dhe Task-Forcës Operacionale Vendore (TFOV), me urdhër të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

Task-Forca Ndërinstitucionale përfaqëson një mekanizëm të nivelit të lartë vendimmarrës, i cili drejtohet nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe ka në përbërje anëtarë, si më poshtë:

- Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Ministri i Financave
- Ministri i Mbrojtjes
- Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor

- Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit

Kjo Task-Forcë përbën organin kryesor strategjik që mbikëqyrë dhe udhëheq përgjigjen në situatat e përshkallëzuara, nga skenari portokalli në skenarin e kuq, duke garantuar ndërveprim të drejtpërdrejtë ndërmjet institucioneve vendimmarrëse dhe strukturave zbatuese në terren.

Task-Forca mbështetet nga Sekretariati teknik, në përbërjen e të cilit janë përfaqësues nga të gjitha institucionet e përfshira, si dhe raporton në mënyrë periodike, çdo javë tek Kryeministri i Republikës së Shqipërisë.

Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Krizës Migratore (QKKM) është parashikuar për t'u ngritur që nga skenari portokalli dhe do të funksionojë si një strukturë operationale e përkohshme, e vendosur pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me një rol kyç në koordinimin taktik dhe menaxhimin e përditshëm të situatës së krijuar nga flukset e përshkallëzuara migratore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr.95 datë 12.6.2024 “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Hartimin e Planit të Kontigjencës për Flukset e Përziera Migratore”.

Në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës, kanë marrë pjesë anëtarët e GNP-së, si dhe janë ftuar dhe kanë marrë pjesë ekspertë të organizatave ndërkombëtare, agjencive të BE-së, apo ekspertë të jashtëm, sipas nevojave që lidheshin me hartimin e këtij plani.

Hartimi i Planit të Kontigjencës është drejtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe reflekton kontributin dhe komentet e Ministrive dhe institucioneve përgjegjëse, Agjencive të BE-së si EUAA dhe Frontex dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në vendin tonë (UNHCR, IOM, etj.), me të cilat, gjatë kësaj periudhe, janë shkëmbyer të dhëna dhe është marrë informacion.

Me qëllim finalizimin e këtij plani janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

- Më datë 4 dhjetor 2024, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, u mbajt takimi i parë i grupit të punës për hartimin e Planit të Kontigjencës, për flukset e përziera migratore, miratuar me urdhër të Kryeministrit, Nr.95, datë 12.6.2024.
- Në datat 1-3 prill 2025 u zhvillua workshopi i parë kombëtar, ku u diskutua mbi Planin e mëparshëm të Kontigjencës të Shqipërisë, boshllëqet dhe aspektet metodologjike që duhet të shërbejnë për planifikimin e Kontigjencës, si dhe u prezantua eksperiencia e Kosovës dhe ajo e Sllovenisë;
- Në vijim të punës për hartimin e Planit të Kontigjencës dhe në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 95, datë 12.06.2024, u zhvillua në datat 21–22 maj, workshop-i i dytë kombëtar; Në këtë takim u punua me analizën e situatës si dhe indikatorët e paralajmërimit të hershëm;
- Workshopi i tretë u zhvillua 9-10 qershor 2025, në këtë takim u finalizua mekanizmi i drejtimit të planit, nevoja për ngritjen e një task-force si dhe u përcaktuan indikatorët sipas skenarëve të emergjencës;
- Workshopi i katërt u zhvillua në datat 21-23 korrik 2025 në Shkodër me pjesëmarrjen e anëtarëve të GNP-së dhe partnerëve të IOM, UNHCR, EUAA dhe FRONTEX. Në këtë takim u rishikua drafti i planit dhe u finalizua një version final i dakordësuar.

Me shkresën nr. 5224/1 Prot., datë 07.10.2025 projektakti u dërgua për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Shërbimit Informativ të Shtetit.

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, më datë 27.10.2025 **është shprehur në parim dakord.**

2. Shërbimi Informativ i Shtetit, me shkresën nr. 1592/1 Prot., datë 20.10.2025, është shprehur dakord, duke sugjeruar si vijon:

“Në paragrafin e pestë të pikës 7.2 të projektvendimit, propozohet që fjalia e dytë të ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

Ishte: *Dy rrugët kryesore të migrimit përmes Ballkanit Perëndimor janë: rruga qendrore përmes Serbisë dhe rruga përmes Shqipërisë, të cilat mbeten aktive duke krijuar flukse drejt veriut në gjithë rajonin.*

Propozimi: *“Itineraret kryesore të migrimit përmes Ballkanit Perëndimor janë: Turqi–Greqi–Maqedonisë së Veriut (RMV)–Serbi–BH–Kroaci–Slloveni–Itali/Gjermani; dhe Turqi–Greqi–RMV–Serbi–Hungari, të cilat mbeten aktive duke krijuar flukse migratore drejt vendeve të BE-së.”*

Ky ndryshim propozohet me argumentimin që nga të dhënat që disponojmë, Shqipëria konsiderohet si rrugë alternative e Rrugës së Ballkanit Perëndimor, për vetë faktin se numri i emigrantëve që kalojnë nëpërmjet vendit tonë është shumë i ulët krahasuar me flukset që kalojnë në itineraret përmes RMV dhe Bullgarisë. Po ashtu, terreni malor në kufirin e vendit tonë me Greqinë nuk favorizon flukset në masë dhe i bën më të vështira kalimet duke rritur kostot financiare për emigrantët e parregullt.

Pas paragrafit të gjashtë të pikës 7.2 të projektvendimit, në vlerësimin tonë propozohet të shtohet një paragraf me përmbajtjen e mëposhtme:

“Një tjetër mënyrë që emigrantët përdorin për të kaluar në vendet e BE-së, është keqpërdorimi i vizave të punës apo përdorimi i vizave fiktive të punës. Një pjesë e punëtorëve të kontraktuar nga bizneset vendase, kryesisht nga India, Nepali, Bangladeshi, Sri Lanka, Filipine dhe Pakistani, e përdorin Shqipërinë si urë-kalimi për në vendet e BE-së, duke abuzuar me vizat e punës”.

➤ **Sugjerimet janë pranuar dhe reflektuar në draft.**

3. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, më datë 27.10.2025 është shprehur në parim dakord, brenda kompetencave të saj.

4. Ministria e Drejtësisë, me shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, më datë 20.10.2025 është shprehur në parim dakord, brenda kompetencave të saj.

5. Ministria e Financave, me shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, më datë 20.10.2025 është shprehur me komente, si vijon:

- “Implementimi i këtij plani rezulton me kosto të cilat janë përlllogaritur sipas 4 skenarëve.

Skenari Jeshil rezulton me hendek minimal financiar dhe me kosto të planifikuara brenda tavaneve buxhetore për periudhën 2026-2028.

Ndërkohë, sa i përket skenarëve të verdhë, portokalli dhe të kuq, konstatojmë që ka mospërputhje në përlllogaritjet financiare të bëra në tabelën e relacionit shoqërues të projektvendimit dhe narrativës shpjeguese.

Vlerësojmë të rishikohen kostot vjetore dhe hendeqet financiare në tekstin shpjegues në përputhje me përlllogaritjet e tabelës.

Në aspektin e qëndrueshmërisë financiare, të tre skenarët rezultojnë me hendeqe financiare të larta mbi 48%, të cilat në rast se do të materializohen do të kërkojnë financime të shtuara nga buxheti i shtetit.

Në këto kushte, kërkojmë që institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij plani të marrin masa për të planifikuar në kohë në buxhetet afatmesme nevojat financiare adekuatë në linjë me skenarët potencial për materializim. ”

➤ Sugjerimet **janë pranuar** dhe reflektuar.

6. Ministria e Mbrojtjes, me shkresën e datës 4.11.2025 të dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, **është shprehur me komente, si vijon:**

- “Në pikën 7.1 “Kuadri ligjor”, në seksionin 7 të planit “Planifikimi dhe përgatitja”, të vendoset edhe ligji nr. 51, datë 03.07.2025 “Për rezervat materiale të shtetit”, për të legjitimuar procedurën e përfshirjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezerave Materiale të Shtetit, si strukturë operacionale në ofrimin e ndihmës me të mira materiale, si domosdoshmëri për shmangien e vonesave apo keqorientimit procedural, të dhënies ose përfitimit të ndihmës me mallra rezervë shteti. Në ndërhyrje të tillë në projektvendim do të përfshihen të gjitha strukturat të përfshira në zbatimin e planit.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në aneksin III të “Planit kombëtar të kontingjencës për flukset e përziera migratore për vitet 2026-2028 - Qarku Vlorë”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

a) Nga “Qarku Vlorë”, pika 1. “Bashkia Vlorë” **të hiqet “Reparti Ushtarak i Bunavisë”**, pasi ky është një repart aktiv dhe dislokimi i përkohshëm i këtij kontingjenti cënon rregullat dhe sigurinë lidhur me aktivitetin e përhershëm të këtij reparti.

b) Nga “Qarku Vlorë”, pika 3. “Bashkia Delvinë”, **lidhur me ish-Repartin ushtarak të këmbëtorisë pas godinës së bashkisë dhe ish-Repartin ushtarak pika e tankeve**, Qafë e Breshësit, Bajkaj Delvinë, duke qenë se aktualisht këto dy reparte janë jashtë Planit të Vendosjes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mund të përdoren për dislokimin e përkohshëm të flukseve migratore.

Lidhur me komentin e dytë ju bëjmë me dije se gjatë fazës së hartimit të planit nga grupi i punës nga përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura nuk është dakordësuar përfshirja e reparteve në këtë plan.

➤ Sugjerimet **janë pranuar** dhe reflektuar në draft.

7. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me shkresën e datës 3.11.2025 të dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, **shprehet parimisht dakord duke sugjeruar si më poshtë vijon:**

- “Në faqen 11, paragrafi “*Persona që i përkasin kategorisë së veçantë*”: formulimi i togfjalëshit në dokument “*probleme/çrregullime*”, sugjerojmë të formulohet në togfjalëshin “*çrregullime të shëndetit mendor*”.
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.
- Në faqen 14, paragrafi i dytë, “Objektivi 2”, rreshti 5: formulimi i togfjalëshit në dokument “*shërbime shëndetësore*” sugjerojmë të formulohet në togfjalëshin “*shërbimet sociale dhe shëndetësore*”.
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.
- Në faqen 35, seksioni "Sistemi i pritjes lidhur me shërbimet sociale", te institucionet përgjegjëse, propozojmë (propozim i bërë në disa raunde konsultimi) të shtohen "Bashkitë", si aktorë kryesore, institucioni përgjegjës për manaxhimin e rasteve, përfshirë dhe fëmijët e pashoqëruar, dhe referimin e tyre në institucionet e përkujdesit në nivel vendor.
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.
- Në faqen 40, Seksioni 8 “Qeverisja - reagimi, koordinimi dhe menaxhimi i emergjencave në flukse të papritura migratore”, paragrafi lidhur me rolin e MSHMS, për kujdesin social, sugjerojmë të riformulohet duke patur parasysh komentin e bërë nga MSHMS, gjatë takimeve konsultuese, si më poshtë vijon:

“Në fushën e mbrojtjes sociale, MSHMS-ja luan një rol qendror në hartimin dhe koordinimin e politikave për ofrimin e kujdesit social ndaj grupeve vulnerabël brenda flukseve migratore, sipas përcaktimeve të ligjit në fuqi të shërbimeve sociale dhe standardeve të shërbimeve sociale. Përfitojnë shërbime shtetasit e huaj me leje qëndrimi në Shqipëri, vetëm në rastet kur një i huaj ka marrë statusin e azilit, apo që gezon mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët”.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 40 të paragrafit të dytë: *Paragrafi “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) ka një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe koordinimin e përgjigjes shëndetësore ndaj flukseve migratore. Siguron akses në shërbime shëndetësore bazë dhe të urgjencës për migrantët, refugjatët dhe azilkërkuesit, si dhe mbikëqyrjen epidemiologjike dhe menaxhimin e sëmundjeve ngjitëse”.*

Sugjerojmë të korrigjohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) në këtë paragraf dhe në të gjithë tekstin e dokumentit. Gjithashtu fjala "Siguron" të zëvendësohet me togefjalëshin “nëpërmjet sigurimit të” dhe togefjalëshi “sëmundjeve ngjitëse” të zëvendësohet me “ngjarjeve epidemiologjike”.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 40 në pikën: Organizatave ndërkombëtare, si IOM, UNHCR, UNICEF, në mbështetjen e operacioneve në terren, ofrimin e ndihma teknike dhe materiale, si dhe në mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe azilkërkuesve. Sugjerojmë të shtohet edhe “OBSH”.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 52, në skenarin jeshil, sesioni "mirëqenia sociale", në ndërhyrjen "Trajnime të vazhdueshme për punonjësit socialë, punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve dhe personelin mjekësor në nivel rajonal dhe lokal për trajtimin e migrantëve, identifikimin, referimin dhe mbështetjen e personave vulnerabël" ku ngarkohet vetëm MSHMS për realizimin e tij, kemi sugjeruar dhe sugjerojmë që të shtohen dhe strukturat e tjera: Bashkitë, ASHMDF, SHSSH, OJF.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 54, Plani Operacional- Skenari Jeshil në Sektorin e Shëndetësisë: Formulimi në dokument:
 - I. Trajnimi i personelit spitalor për trajtimin e Migrantëve;
 - II. Hartimi i një udhëzuesi të dedikuar për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për flukset e përziera migratore (është hequr si aktivitet që në takimin e fundit të grupit të punës në Shkodër).

Sugjerime të formulohen si më poshtë:

- I. Trajnimi i stafeve të institucioneve shëndetësore për njohjen e faktorëve socialë, gjuhësorë dhe kulturorë që ndikojnë në aksesin dhe përvojën e migrantëve me shërbimet shëndetësore.
- II. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për migrantët nga strukturat spitalore vendore të kujdesit shëndetësor pranë pikave të kalimit kufitar, në zbatim të sistemit të referimit.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 55, në skenarin e verdhë", ndërhyrja "Vendosja e punonjësve social dhe psikologëve në gatishmëri për angazhim të menjëhershëm" sugjerime të riformulohet sipas propozimit të bërë nga MSHMS "*Vendosja e punonjësve social dhe psikologëve të strukturave vendore në gatishmëri për angazhim të menjëhershëm*". Në këtë logjikë, kërkojmë që të përfshihen në institucionet përgjegjëse dhe ASHMD, SHSSH.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 56, Plani Operacional - Skenari i Verdhë në Sektorin e Shëndetësisë, në fushën e shëndetësisë, kolona "Afati zbatimi": *Menjëherë; sugjerime të formulohet si më poshtë "Brenda 72 orëve", pasi urgjencat mjekësore trajtohen menjëherë dhe brenda 72 orëve problematikat e tjera shëndetësore.*

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 59, te skenari portokalli, seksioni "*mirëqenia sociale*", ndërhyrja "*Vendosja e punonjësve social, psikologëve dhe PMF 24/7 në kufi dhe qendrat e pritjes*" sugjerime zgjerimin e masës duke shtuar paragrafin "*....në bashkëpunim dhe koordinim me organizatat ndërkombëtare, kryesisht për rastet e të miturve të pashoqëruar*". Në këtë logjikë

sugjerojmë që në institucionet përgjegjëse, krahas MSHMS, Bashkitë, OJQ të shtohet ASHDMF dhe SHSSH.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Po në këtë faqe, te ndërhyrja *"Identifikimi dhe referimi i fëmijëve të mitur të pashoqëruar /viktimave të trafikut"*, sugjerojmë të hiqet SHSSH si institucion përgjegjës dhe të shtohet ASHDMF, si institucioni përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, përfshirë dhe fëmijët e pashoqëruar.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Po në këtë faqe, te ndërhyrja *"Riorganizimi i hapësirave/personelit në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Viktimat e Trafikimit"*, sugjerojmë të hiqet nga institucion përgjegjës MSHMS dhe të vendoset MPB, si institucioni që ka në fushë përgjegjësie ngritjen dhe funksionimin e qendrave pritëse.

➤ Sugjerimi **nuk është pranuar**. Riorganizimi i hapësirave/personelit në Qendrën Kombëtare të Pritjes për Viktimat e Trafikimit është në fushën e përgjegjësisë së MSHMS. Gjithashtu, në këtë masë nuk bëhet fjalë për ngritje të ndonjë qendre të re por në riorganizimin e një qendre tashmë të ngritur dhe nën varësinë e SHSSH.

- Po në këtë faqe, te ndërhyrja *"Rritja e rezervave ushqimore/higjeno-sanitare për 375 emigrantë në javë"*, sugjerojmë të hiqet nga fusha e përgjegjësisë SHSSH, pasi nuk e ka fushë kompetence.

➤ Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

- Në faqen 60, Plani Operacional - Skenari Portokall në Sektorin e Shëndetësisë: Formulimi në dokument:

- I. Vendosja e 9 ekipeve mjekësore statike/mobile 24/7 në Vlorë, Korçë, Gjirokastër
- II. Emërimi i koordinatorit shëndetësor për secilin rajon (*është hequr si aktivitet që në takimin e fundit të grupit të punës në Shkodër*)
- III. Vendosja e 3 epidemiologëve në pikat kufitare/qendrat e pritjes.

Sugjerojmë të formulohet si më poshtë:

- I. Vendorsja e 9 Ekipeve statike/të lëvizshme mjekësore dhe logjistika përkatëse për mbulimin me shërbim shëndetësor 24/7, në Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër;
 - II. Angazhimi i epidemiologëve të strukturave vendore të kujdesit shëndetësor pranë pikave kufitare /qendrave pritëse.
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.
- Në faqen 60, *Plani Operacional- Skenari kuq në Sektorin e Shëndetësisë: Formulimi në dokument “Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe publike për 700 migrantë/në javë” sugjerojmë të riformulohet “Ofrimi i shërbimeve mjekësore dhe të shëndetit publik për 700 migrantë/në javë”.*
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.
- Në vijim propozojmë që edhe për skenarin e kuq, përsa i takon shërbimit shëndetësor, të ruhet rendi i sektorëve sipas tre skenarëve të tjerë dhe nëse do dakordësohet që do të vendosen edhe institucionet kryesore të varësisë, në kolonën e tretë përveç MSHMS të shtohen OSHKSH, ISHP, QKUM, FSDKSH së bashku me OBSH, EU dhe partnerët të tjerë për tre skenarët, përveç skenarit jeshilit.
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.
- Së fundmi, sugjerojmë që mbështetja nga partnerët të parashikohet për skenarin e verdhë, portokalli dhe të kuq;
- Sugjerimi **është pranuar** dhe reflektuar në draft.

8. Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, me shkresën e dërguar nëpërmjet sistemit e-aktet, më datë 13.11.2025 është shprehur në parim dakord brenda fushës së përgjegjësisë, me sugjerimin që projektvendimi t’i nënshtohet konsultimit në Këshillin Konsultativ ndërmjet Qeverisë Qëndrore me Vetëqeverisjen Vendore.

- Sugjerimi **është pranuar** dhe projektvendimi është dërguar për diskutim në Këshillin Konsultativ.

9. Agjencia Evropiane për Azilin (EUAA) dhe FRONTEX, me komentet e dërguara në rrugë elektronike, sugjerojnë:

- “Kemi vënë re disa elementë të rëndësishëm që do të ishin thelbësorë për Planin e Kontigjencës, ndaj ju lutemi na lejoni t’ju rikthehemi me këto 3 komente kryesore:

1.Verifikoni / konfirmoni afatin kohor – versioni më i fundit në anglisht që na u nda tregon periudhën 2026–2030, ndërsa versioni në gjuhën shqipe tregon 2026–2028, që pasqyron diskutimet gjatë hartimit dhe është në përputhje me praktikat e BE-së.

2.Metodologjitë e EUAA dhe Frontex rekomandojnë që një Plan Kontigjence të rishikohet rregullisht, çdo 2–3 vjet. Në rastin e Shqipërisë, është e rëndësishme të ketë një fazë (testimi dhe) rishikimi, për të kompensuar afatet e ngushta kombëtare të këtij versioni. Kjo mund të sigurohet duke përshkruar ciklin e rishikimit në Planin e Kontigjencës, sipas metodologjisë së Frontex/EUAA. Në lidhje me këtë, vumë re se nuk ka asnjë përmendje të ciklit të rishikimit në draftin e ndarë. Sipas metodologjisë së përcaktuar, Shtetet Anëtare të BE-së (në këtë rast Shqipëria) duhet të specifikojnë një cikël rishikimi në Plan – si, kur dhe në çfarë mase (konkretisht) sugjerimet për përshtatje merren parasysh gjatë ciklit të rishikimit.

3.EUAA figuron si aktor përgjegjës në skenarin e kuq – ju kujtojmë se EUAA nuk ka mandat operacional në vendet jo-anëtare të BE-së, prandaj kjo duhet korrigjuar.”

➤ Sugjerimet **janë pranuar** dhe reflektuar në draft.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektakti ka efekte shtesë në buxhetin e shtetit. Procesi i kostimit është realizuar duke marrë në konsideratë skenarët apo modelin e përshkallëzimit të flukseve migratore dhe kostot indikative dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të Planit Kombëtar të Kontigjencës për flukset e përziera migratore, për vitet 2026–2028. Numri i skenarëve është katër dhe secili nga skenarët qëndron më vete.

Vlerësimi i kostove është kryer në përputhje me **metodologjitë e planifikimit buxhetor**, pra mbështetet në qëllimet, objektivat, treguesit e performancës dhe burimet e të identifikuar nga ekspertët për secilin aktivitet dhe/ose sektor.

Përlllogaritjet e kostove indikative janë kryer duke **detajuar zërat e shpenzimeve për secilin aktivitetet**, të përshtatur sipas informacioneve të marra nga ekspertët e

sektorit dhe janë harmonizuar me **Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028**, për aq sa ka qenë e mundur. Ky proces është zhvilluar në konsultim me antarët e grupit të punës, disa nga drejtoritë përkatëse të buxhetit në ministritë e linjës, institucionet e përfshira në zbatimin e planit të kontigjencës, sugjerimet e ekspertëve ndërkombëtar, etj.

Plani Kombëtar i Kontigjencës shoqërohet me një kostim **analitik**, i cili përfshin një klasifikim të shpenzimeve në kategori të qarta si:

- Paga dhe sigurime shoqërore;
- Shpenzime të tjera korrente;
- Investime.

Përlllogaritjet janë realizuar sipas viteve financiare, duke paraqitur një shpërndarje të qartë të kostove indikative dhe fondeve që nevojiten për secilin aktivitet. Kostot indikative dhe burimet e financimit duhen lexuar sipas skenarëve.

Skenari Jeshil ose gjendja normale është situatë plotësisht e qëndrueshme dhe nën kontroll. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 195.6 milionë lekë. Fondet që nevojiten për zbatimin e aktiviteteve të planit janë brenda tavanëve buxhetore. Hendek financiar është identifikuar vetëm për vitin 2026 dhe është rreth 3.47 milionë lekë ose 1.8% e kostove indikative të llogaritura për skenarin jeshil për të gjithë periudhën 2026-2028. Ndërsa 10.3% kostove indikative totale janë planifikuar të mbulohen nga organizata partnere dhe/ose organizata ndërkombëtare për periudhën 2026–2028 dhe janë të lidhura kryesisht me ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin.

Skenari i Verdhë ose Paralajmërimi shënon një rritje të lehtë dhe të vazhdueshme të fluksit migrator, duke vendosur sistemin në një nivel më të lartë vigjilence. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 529.4 milionë lekë. Nëse ndodh ky skenar lind nevoja për mbulimin e disa kostove që janë identifikuar si hendek financiar dhe lidhen me transportin e migrantëve, rezervat ushqimore dhe paketat hidrosanitare, si dhe transferimin e migrantëve nga qendrat e përkohshme në objektet e tjera. Kostoja indikative totale e mbuluar nga buxheti është rreth 254 milionë lekë për të gjithë periudhën dhe është e shpërndarë pothuajse në të njëjtin nivel për secilin

vit buxhetor. Hendeku financiar është 48.3% ose rreth 255.8 milionë lekë për të gjithë periudhën 2026-2028 dhe është pothuajse në të njëjtin nivel për çdo vit buxhetor. Ky fond nevojitet vetëm nëse kalohet në këtë skenar.

Skenari Portokalli ose Emergjencia karakterizohet nga rritja të konsiderueshme e fluksit, ku sistemet ekzistuese fillojnë të ndiejnë presion serioz. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 499.5 milionë lekë. Në këtë skenar lind nevoja për mbulimin e disa kostove që janë identifikuar si hendek financiar dhe lidhen me shtimin e facilitetëve dhe posteve të punës, transportin e migrantëve, operimin i 3 qendrave të tjera emergjente, etj. Hendeku financiar është rreth 71.% ose rreth 357.5 milionë lekë për të gjithë periudhën 2026-2028. Ky fond nevojitet vetëm nëse kalohet në këtë skenar. 18.8% kostove indikative për këtë skenar janë planifikuar të mbulohen nga organizata partnere dhe/ose organizata ndërkombëtare.

Tabela1: Kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë periudhës 2026-2028 (në lekë)								
Skenari	Shpenzim e paga + sig shoqerore	Shpenzime të tjera operative	Investime	TOTALI KOSTO INDIKATIVE	Financuar nga buxheti	Financuar nga Donatore/Organi zata Partnere	Hendeku financiar	% e hendekut financiar
1. Normalitet	140,044,061	52,772,059	2,875,000	195,691,120	172,147,582	20,068,539	(3,474,999)	1.8%
Viti 2026	50,183,427	21,037,384	2,875,000	74,095,811	61,678,673	8,942,139	(3,474,999)	4.7%
Viti 2027	44,930,317	15,883,501	-	60,813,818	55,250,618	5,563,200	-	0.0%
Viti 2028	44,930,317	15,851,174	-	60,781,491	55,218,291	5,563,200	-	0.0%
2. Paralajmërim	121,364,878	382,815,353	25,300,000	529,480,231	254,031,678	19,613,430	(255,835,123)	48.3%
Viti 2026	40,454,959	127,605,118	13,800,000	181,860,077	86,977,226	6,537,810	(88,345,041)	48.6%
Viti 2027	40,454,959	127,605,118	5,750,000	173,810,077	83,527,226	6,537,810	(83,745,041)	48.2%
Viti 2028	40,454,959	127,605,118	5,750,000	173,810,077	83,527,226	6,537,810	(83,745,041)	48.2%
3. Emergjencë	226,426,737	241,071,708	32,085,000	499,583,446	47,801,554	94,253,510	(357,528,382)	71.6%
Viti 2026	75,475,579	82,291,383	32,085,000	189,851,962	14,934,933	34,016,755	(140,900,274)	74.2%
Viti 2027	75,475,579	79,390,163	0	154,865,742	20,331,688	26,220,000	(108,314,054)	69.9%
Viti 2028	75,475,579	79,390,163	0	154,865,742	12,534,933	34,016,755	(108,314,054)	69.9%
4. Krizë	292,445,217	385,860,059	30,475,000	708,780,276	91,343,804	159,882,795	(457,553,677)	64.6%
Viti 2026	97,481,739	128,620,020	30,475,000	256,576,759	36,927,935	53,294,265	(166,354,559)	64.8%
Viti 2027	97,481,739	128,620,020	0	226,101,759	27,207,935	53,294,265	(145,599,559)	64.4%
Viti 2028	97,481,739	128,620,020	0	226,101,759	27,207,935	53,294,265	(145,599,559)	64.4%

Skenari i Kuq ose Kriza është skenari më kritik, përfaqëson krizë të plotë, flukset migratore janë shumë të larta dhe tejkalojnë kapacitetet shtetërore. Kostoja indikative totale për zbatimin e planit të kontigjencës për periudhën 2026–2028 sipas këtij skenari është vlerësuar rreth 708.7 milionë lekë.

Në këtë skenar lind nevoja gjithashtu si në rastin e emergjencës për mbulimin e kostove që janë identifikuar si hendek financiar dhe lidhen me rritjen e kontrollit

kufitar, shtimin e facilitetëve dhe posteve të punës, transportin e migrantëve, operimin e qendrave emergjente, etj. Kostoja indikative është rreth 230 milionë lekë në vit. Hendeku financiar është rreth 64.6% ose rreth 457.5 milionë lekë për periudhën 2026–2028, dhe ky fond nevojitet vetëm nëse do të ndodh ky skenar. 22.6% kostove indikative për këtë skenar janë planifikuar të mbulohen nga organizata partnere dhe/ose organizata ndërkombëtare.

Në përlllogaritjen e kostove janë identifikuar dhe kufizime që kërkojnë rishikim të mëtejshëm dhe të vazhdueshëm, në varësi të skenarëve. Në mënyrë të veçantë duhet të planifikohen alokimet që janë të mbuluara nga burimet ekzistuese. Bazuar në analizën e mësipërme, rishikimi i kostove dhe burimeve të financimit mbetet një proces dinamik që do të varet nga flukset migratore.

MINISTRI

Albana KOÇIU